



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 2362 / Prot.

3

Tiranë më 10.10.2023

VENDIM

Nr. 42, datë 09.10 2023

***“Për miratimin e një ndryshimi të vendimit nr.25 datë 04.05.2023, të Senatit Akademik të UT-së, në planin mësimor të ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Gjuhë Angleze”, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, të UT-së, për vitin akademik 2023-2024”***

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 2, gërma “b”; neni 35, pika 9; neni 38, pika 1, gërma “dh”; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, gërma f; si dhe në propozimin e përcjellë nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja me shkresën nr. 824/1 prot., datë 29.08.2023, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 09.10.2023;

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja për një ndryshim, të vendimit nr.25 datë 04.05.2023, të Senatit Akademik, të UT-së.
2. Të saktësojë planin mësimor të ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Gjuhë Angleze”, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, të UT-së lidhur me vendosjen e gjuhës gjermane si gjuhë e huaj e dytë të Grupit të gjuhëve C dhe D, për vitin akademik 2023-2024.
3. Ky vendim t’i përcillet për njoftim Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Prof. Dr. Artan Hoxha

